Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 09.06.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	**Maksimumi i Dhënë**	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- **PIKËT E DHËNA**
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Informacioni i mëposhtëm është marrë nga draft pasqyrat financiare të Malta, një kompani me përgjegjësi të kufizuar.

MALTA
PASQYRA E POZITËS FINANCIAR MË 31 MAJ

	2014		*2015*	
	€'000	€'000	€'000	€'000
Pasuritë afatgjata		4,600		2,700
Pasuritë afatshkurta				
Stoqet	580		500	
Llogaritë e arkëtueshme	360		230	
Paraja në bankë	0		170	
		940		900
Gjithsej pasuritë		5,540		3,600
Detyrimet dhe Ekuiteti				
Ekuiteti				
Kapitali aksionar i zakonshëm		3,500		2,370
Premia e aksioneve		300		150
Fitimet e mbajtura		1,052		470
		4,852		2,990
Detyrimet afatgjata				
10% Nota e pagueshme				
(e pagueshme me 31 Maj 2015)		0		100
Detryimet afatshkurta				
Llogaritë e pagueshme	450		365	
Tatimi i pagueshëm	180		145	
Mbitërheqja bankare	58		0	
		688		510
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		5,540		3,600

Informacione shtesë

(a) Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 maj 2015 tregon si më poshtë.

	€'000
Fitimi operativ	1,042
Shpenzimet e interesit	(10)
Fitimi para tatimit	1,032
Tatimi në fitim	(180)
Fitimi neto	852

(b) Gjatë vitit dividentët e paguara ishin €270,000.

(c) Fitimi para tatimit është arritur pas shpenzimeve së zhvlerësimit për pasuritë afatgjata për €700,000.

(d) Gjatë vitit, pasuritë afatgjata me vlerë neto në libra prej €200,000 u shitën për €180,000.

Kërkohet

Përgatitni pasqyrën e rrjedhës së parasë për Malta për vitin që përfundon më 31 maj 20X5 në përputhje me SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë, duke përdorur metodën indirekte.

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

MALTA - KOMPANI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 MAJ 2015

	€'000	€'000
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	1,032	
Rregullime për:		
Shpenzimet e zhvlerësimit	700	
Humbja në shitjen e pasurive afatgjata	20	
Shpenzimet e interesit	10	
	1,762	
Fitimi operativ para ndryshimeve të kapitalit		
Rritja në stoqe	(80)	
Rritja në llogaritë e arkëtueshme	(130)	
Rritja në llogaritë e pagueshme	85	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	1,637	
Interesi i paguar	(10)	
Tatimi në fitim i paguar (LL1)	(145)	
Dividentët e paguara	(270)	
Rrjedha neto nga aktivitetet operative		**1,212**
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet investive		
Blerja e pasurive afatgjata(LL2)		(2,800)
Arkëtimet nga shitja e pasurive afatgjata		180
Rrjedha neto nga aktivitetet investuese		**(2620)**

Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		
Të ardhurat nga emetimi i kapitalit aksionar	1,280	
Ripagimi i huamarrjes afatgjate	(100)	
Rrjedha neto nga aktivitetet financuese		**1,180**
Neto rritja/ (zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të saj gjatë vitit		(228)
Paraja dhe ekuivalentët e saj, në fillim të vitit		170
Paraja dhe ekuivalentët e saj, në fund të vitit		(58)

Shënim. Dividentët e paguar dhe pagesat e interesit mund të paraqiten në aktivitetet operative ose në aktivitete financuese.

Llogaritjet

1 *Tatimi i paguar*

TATIMI

	€'000		€'000
Tatimi i paguar	145	Saldo fillestare	145
Saldo në fund	180	Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	180
	325		325

2 *Pagesat për pasuritë e prekshme afatgjata*

PASURITË E PREKSHME AFATGJATA

	€'000		€'000
Saldo fillestare	2,700	Shpenzimet e zhvlerësimit	700
Blerjet	2,800	Shitja e pasurive	200
		Saldo në fund	4,600
	5,500		5,500

Problemi 2

Presheva është kompania mëmë e Nartit. Më poshtë janë pasqyrat e pozicionit financiar për të dy kompanitë më 31 Tetor 2017.

	Presheva		*Narti*	
	€'000	€'000	€'000	€'000
Pasuritë				
Pasuritë jo-qarkulluese				
Prona, pajisjet dhe impiantet		4,200		3,300
Investimet: aksionet në Narti sipas kostos		3,345		–
Pasuritë qarkulluese				
Stoqet	1,500		800	
Llogaritë e arkëtueshmet	1,800		750	
Paraja në bankë	600		350	
		3,900		1,900
Gjithsej pasuritë		11,445		5,200
Detyrimet dhe Ekuiteti				
Ekuiteti				
€1 Aksionet e zakonshme		9,000		4,000
Fitimet e mbajtura		525		200
		9,525		4,200
Detyrimet afatshkurtëra				
Llogaritë e pagueshme		1,220		200
Tatimi		700		800
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		11,445		5,200

Informacioni i mëposhtëm është gjithashtu i disponueshëm.

(a) Presheva bleu 2,800,000 aksione në Narti një vit më parë kur Narti kishte fitimin e mbajtur €60,000. Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në datën e blerjes ishte €1,415,000.

(b) Gjatë vitit Presheva shiti mallra me një vlerë fature prej €240,000 për Nartin. Këto mallra janë faturuar me shtim mbi kosto 20%. Gjysma e mallrave janë ende në inventarin e Nartit në fund të vitit.

(c) Narti i detyrohet Preshevës €30,000 më 31 Tetor 2017 për mallrat e blera gjatë vitit.

Kërkohet

(a) Llogaritni emrin e mirë për blerje. **(5 pikë)**

(b) Përgatitni pasqyrën e konsoliduara të pozicionit financiar për grupin Prestend më 31 Tetor 20X7.

Shënimet shpjeguese nuk janë të nevojshme.

(15 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 2

(a) Llogaritja e emrit të mirë për blerjen e Northon

	€	€'000
Vlera e drejtë e konsiderates së transferuar		3,345
Plus vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në blerje		1,415
Minus vlera e drejtë e blerjes neto e pasurive të identifikueshme dhe detyrimeve të marra:		
Kapitali aksionar i zakonshëm	4,000	
Fitimet e mbartura në blerje	60	
		(4,060)
Emri i mirë		700

(b) PRESTEND GRUP

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZITËS FINANCIARE MË 31 Tetor 20X7

	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		
Emri i mirë	700	
Pasuritë e prekshme jo-qarkulluese (4,200 + 3,300)	7,500	
		8,200
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet (1,500 + 800 – 20 (LL2))	2,280	
Llogaritë e arkëtueshmet (1,800 + 750 – 30)	2,520	
Paraja në bankë (600 + 350)	950	
		5,750
		13,950
Detyrimet dhe Ekuiteti		
Ekuiteti		
€1 Aksionet e zakonshme		9,000
Fitimet e mbajtura (P3)		603
Interesit jo-kontrollues (P4)		1,457
		11,060
Detyrimet afatshkurtëra		
Llogaritë e pagueshme (1,220 + 200 – 30)	1,390	
Tatimi (700 + 800)	1,500	
		2,890
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		13,950

Punimet

1 *Struktura e grupit*

Prestend

$$\frac{2,800,000}{4,000,000} = 70\%$$

Northon

2 *Fitimi i parealizuar në shitjet brenda grupit*

Fitimi në shitjen brenda grupit është €240,000 × $\frac{20}{120}$ = €40,000

∴ Fitimi i parealizuar është €40,000 × 50% = €20,000

3 *Fitimet e mbajtura*

	Prestend €'000	*Northon* €'000
Sipas pyetjes	525	200
Rregullimi (fitimi i parealizuar (LL2))	(20)	
Fitimet e mbajtura para blerjes		(60)
		140
Pjesa e grupit e fitimeve të mbajtura pas blerjes:		
Northon (70% × 140)	98	
Fitimet e mbajtura të grupit	603	

4 *Interesi jo-kontrollues*

	€'000
Vlera e drejtë e interest jo-kontrolluese në blerje	1,415
Plus pjesa e interesit jo-kontrollues të fitimeve të mbajtura pas blerjes	42
(30% × 140)	
Interesi jo kontrollues në datën e raportimit	1,457

Problemi 3

Bilanci vërtetues për Z. Redi, pronar i një dyqani në Pejë, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016 nuk barazohet. Z. Redi ka identifikuar çështjet e mëposhtme por është i pasigurt si t'i regjistroj ato dhe ju është drejtuar juve për ndihmë për rregullimet e duhura :

1. Kthimet e blerjeve prej 964€ janë debituar gabimisht në llogarinë e blerjeve.

2. Një kredi afatgjate e marrë prej 10,000€ është kredituar gabimisht në llogarinë e kapitalit.

3. Një pagesë prej 1,000 €e paguar për 'Të pagueshmet tregtare të T Shala' është kredituar gabimisht në ' Të arkëtueshmet e M. Shala' .

4. Duke kontrolluar listën e çeçeve, Redi ka kuptuar se kishe regjistruar aksidentalisht shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes prej 900€ si shpenzimet të sigurimit.

5. Z. Redi morri mallrat në vlerë prej 1,000€ nga dyqani i tij për në shtëpi për një festë personale. Asnjë korrigjim nuk është përfshirë në pasqyrat financiare lidhur me këtë transaksion.

6. Interesi në depozita prej 400€ i cili lidhet me një llogari personale të depozitave është përfshirë në bilancin provues të biznesit duke debituar shpenzimet e interesit bankar dhe duke kredituar llogarinë pezull .

Kërkohet:

(a) Përgatisni hyrjet në ditar për Z. Redi për të regjistruar dhe korrigjuar transaksionet relevante nga informatat e mësipërme për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016. (13 pikë)

(b) Përgatisni Llogazinë Pezull dhe kalkuloni saldon fillestare të saj në fillim. (4 pikë)

(c) Identifikoni gabimet të cilat mund të zbulohen gjatë përgatitjes së bilancit vërtetues. (3 pikë)

[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 3

a)

1. Debi : Llogaria Pezull	1,928	
Kredi : Kthimet e Blerjeve		964
Kredi : Blerjet		964
2. Debi : Kapitali	10,000	
Kredi : Kredia Bankare Afatgjate		10,000
3. Debi : Llogaritë e Pagueshme	1,000	
Debi : Llogaritë e Arkëtueshme	1,000	
Kredi : Llogaria Pezull		2,000
4. Debi : Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes	900	
Kredi : Shpenzimet e sigurimit		900
5. Debi : Tërheqjet	1,000	
Kredi : Blerjet		1,000
6. Debi : Llogaria Pezull	400	
Kredi : Shpenzimet e interesit bankar		400

b)

Llogaria Pezull

1 Kthimet e Blerjeve	964	Saldo fillestare	328
1 Blerjet	964	**3** LL/P	1,000
6 Shpenzimet e interesit bankar	400	**3** LL/A	1,000
	2,328		2,328

(c) Gabimet permutative
Gabimet e mungesës (lënia jashtë e njërës anë të regjistrimit)
Gabimet në kryerjen e detyrës (regjistrimet vetëm në njërën anë, p.sh. dy regjistrime në debi)

Problemi 4

a) Bilancet e mëposhtme janë nxjerrë nga regjistrat e kontabilitetit të Artës, një kompani me përgjegjësi të kufizuar, më datë 31 Dhjetor 2017:

	REFERENCA PER SHENIMET	€
Shitjet	2	3,845,000
Stoqet ne fillim		360,000
Blerjet	3	2,184,000
Shpenzimet e transporti për blerje		119,000
Shpenzimet e transportit për shitje		227,000
Pajisjet e zyrës më datë 1 Janar 2017	2, 3 dhe 4	
Kostoja		460,000
Zhvlerësimi i akumuluar		92,000
Llogarite e arkëtueshme		620,000
Lejimet për borxhet e këqija më datë 1 Janar 2017	5	20,000
Borxhi i keq i fshirë gjatë vitit		15,000
Shpenzime të tjera administrative	6	416,000

Informata e mëposhtme janë në dispozicion:

(1) Stoqet përfundimtare kanë vlerën € 450,000

(2) Disa pajisje te zyrës, të cilat kishin kosto €20,000, me zhvlerësim të akumuluar më datë 1 Janar 2017 në vlerë prej €14,000, ishin shitur për € 15,000 gjatë vitit. Të ardhurat nga shitja janë të përfshira në shifrën e ***shitjeve*** prej €3,845,000.

(3) Kostoja e pajisjeve të reja të blera më 1 Korrik 2017 për €60,000 janë të përfshira në shifrën e blerjeve prej €2,184,000

(4) Kompania zhvlerëson pajisjet e saja të zyrës me 20 për qind në vit me metodën lineare, me aplikimin e zhvlerësimit ***proporcional në vitin e blerjes*** mirëpo nuk aplikon asnjë shpenzim zhvlerësimi në vitin e shitjes. Asnjë pajisje e mbajtur më 1 Janar 2017 nuk ishte më shumë se tri vjet e vjetër.

(5) Lejimet për borxhet e dyshimta më 31 Dhjetor 2017 duhet te jenë **5%** e llogarive të arkëtueshme.

(6) Akrualet dhe parapagimet për shpenzimet e tjera administrative më 31 Dhjetor 2017 të paregjistruara ishin:

	€
Shpenzimet akruale	28,700
Parapagimet për shpenzime	14,400

(7) Drejtoret propozuan një dividend prej 6 cent për aksion për aksionet e rregullta të kapitalit (4,000,000 aksione me çmim 25 cent secila) që do të paguhet në Korrik të vitit 2018. Asnjë dividend nuk është paguar dhe deklaruar në vitin 2017.

Kërkohet:

i) Përpiloni pasqyrën e të ardhurave të kompanisë për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2017. (10 pikë)

b) Në regjistrat kontabël të Genta Sh.p.k më 31 dhjetor 2017, ekzistojnë saldot e mëposhtme.

	€'000
Kostot e zhvillimit të kapitalizuara	180
Kostot e hulumtimit dhe zhvillimit për vitin	162

Për përgatitjen e pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrës së pozitës financiare më 31 dhjetor 2017 janë të rëndësishme informatat e mëposhtme .

(a) Totali prej 180,000 € për kostot e zhvillimit më 1 janar 2017 kanë të bëjnë me dy projekte:

	€'000
Projekti 836: projekt i kompletuar	82
(saldo që amortizohet gjatë periudhës që priten përfitime nga ajo. Shuma që do të amortizohet në vitin 2017 :20,000€)	
Projekti 910: në vazhdim	98
	180

(b) Kostot e hulumtimit dhe zhvillimit për vitin përbëhen nga:

	€'000
Kostot e hulumtimit	103
Kostot e zhvillimit të Projektit 910 i cili vazhdon përmbushë kërkesat e SNK 28 për kapitalizim	59
	162

Kërkohet:

Sipas SNK 38 Pasuritë e paprekshme, çfarë shume duhet të ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për kostot e hulumtimit dhe zhvillimit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017 dhe çfarë shume duhet të shpaloset si pasuri e paprekshme në pasqyrën e pozitës financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017?

(10 pikë)

(Totali 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

a) **Monika**

Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017

			€	€
Shitjet	(3,845,000 – 15,000)			3,830,000
MINUS:	Kosto e shitjes			
	Stoqet në fillim		360,000	
	Blerjet (2,184,000 – 60,000)		2,124,000	
	Shpenzimet e transportit për blerje		119,000	
			2,603,000	
MINUS:	Stoqet përfundimtare		450,000	2,153,000
Bruto fitimi				
PLUS	Fitimi nga shitja e pajisjes	(LL4)	9,000	**1,677,000**
MINUS	Shpenzimet			
	Shpenzimet tjera administrative	(LL1)	430,300	
	Shpenzimet e transportit për shitje		227,000	
	Borxhet e këqija dhe te dyshimta	(LL2)	26,000	
	Zhvlerësimi	(LL3)	94,000	
				768,300
Neto fitimi për vitin				**908,700**

LLOGARITJET		€	€
1	Shpenzimet tjera administrative		
	416,000 + 28,700 – 14,400		430,300
2	Borxhet e këqija dhe të dyshimta		
	Borxhet e këqija të fshira	15,000	
	Lejimet (31,000* – 20,000)	11,000	26,000
3	Zhvlerësimi		
	(460,000 – 20,000) x 20 për qind	88,000	
	60,000 x 20 për qind x 6/12	6,000	94,000
4	Fitimi nga shitja e pajisjes		
	15,000 të ardhurat nga shitja minus 6,000 (vlera neto në libra)		9,000

*31,000=620,000 x 5%. Nuk duhet te përfshihet borxhi i keq ne kalkulimin e Lejimit pasi qe ai veq eshte shlyer dhe shuma e LL/A prej 620,000 paraqet saldon ne fund pas shlyerjes.

b)

P/A:

123,000 €. Kostot e hulumtimit 103,000 € + amortizimi i kostove të zhvillimit 20,000 €.

B/GJ:

Kostot e zhvillimit

219,000 €. (s/b 180,000 € + shtesat në projektin 910 59,000 €) – amortizimi 20,000 €.

Problemi 5

Llogaria e librit te arkës e Albina Sh.P.K. për muajin dhjetor 2013 ishte si në vijim:

Debi			Libri i arkës i Albina Sh.P.K.			Kredi
Data	**Arkëtimet**	**€**	**Data**	**Pagesat**	**Nr.Çekut**	**€**
01/12/2013	Saldo fillestare	6,842	01/12/2013	Interesi Bankar	D.D.	64
03/12/2013	J. Mehmeti	1,474	02/12/2013	T. Kodi	2145	1,475
11/12/2013	T. Zyma	3,582	06/12/2013	J. Rexha	2146	245
16/12/2013	Depozitimet e kesh-it	356	11/12/2013	Elektriciteti com	D.D.	685
23/12/2013	Brin Garazhë	4,125	14/12/2013	T. Nexhmiu	2147	412
30/12/2013	Depozitimet	3,245	17/12/2013	B. Reshepi	2148	124
			20/12/2013	T. Maloku	S.O.	68
			23/12/2013	J. Lahu	2149	452
			28/12/2013	F. Demaku	2150	325
			29/12/2013	J. Roberti	2151	4,589
			31/12/2013	Saldo e/b		11,185
		19,624				19,624
31/12/2013	Saldo ne fund	11,185				

Në vijim është Ekstrakti Bankar për Albina Sh.P.K. për muajin dhjetor 2013:

Ekstrakti Bankar për Albina Sh.P.K. për dhjetor 2013

Data	Përshkrimi	Pagesat €	Depozitimet €	Saldo €
01/12/2013	Saldo			7,246
01/12/2013	Interesi Bankar	64		7,182
02/12/2013	Çek	216		6,966
04/12/2013	Çek	1,457		5,509
04/12/2013	Depozitimet		1,474	6,983
06/12/2013	Çek	188		6,795
10/12/2013	Çek	245		6,550
11/12/2013	Elektriciteti com D.D.	685		5,865
12/12/2013	Transfer kreditor		3,582	9,447
16/12/2013	Tarifat Bankare	145		9,302
16/12/2013	Depozitimet		365	9,667
19/12/2013	Çek	124		9,543
20/12/2013	T. Maloku S.O.	68		9,475
21/12/2013	54789311		845	10,320
24/12/2013	Depozitimet		4,125	14,445
26/12/2013	Çek	452		13,993
27/12/2013	Telekomi Co. D.D.	169		13,824
28/12/2013	Rendi S.O.	987		12,837
29/12/2013	Transfer kreditor		2,582	15,419

Banka ka konfirmuar për Albina Sh.P.K. se ka bërë gabime në llogarinë bankare të Albinës më 21 dhjetor 2013 në shumën 845€. Kjo shume duhet t`i zbritet ekstraktit bankar gjate harmonizimit.

Kërkohet:

Përgatitni harmonizimin bankar për Albina Sh.P.K. më 31 dhjetor 2013. **(20 pikë)**

Zgjidhja e problemit 5

Llogaria Bankare e rregulluar

Dhjetor		**Dhjetor**	
31 Saldo	11,185	31 Shpenzimet bankare	145
31 Çeku 2145 - Diferenca	18	31 Telekomi D.D.	169
31 Depozitimet – Të paregjistruara	2,582	31 Rendi S.O.	987
31 Depozitimet (16/12/13) - Diferenca	9		
		31 Saldo përfundimtare	**12,493**
	13,794		13,794

Harmonizimi i Ekstraktit Bankar

	€	
Saldo mbyllëse e Ekstraktit Bankar - 31/12/2013		**15,419**
Minus Çeçet e paparaqitura		
Çeku 2147	412	
Çeku 2150	325	
Çeku 2151	4,589	**- 5,326**
Shto depozitimet ende të pa miratuara		
Depozitimet - 30/12/2013	3,245	**3,245**
Gabimet bankare		
54789311 - 21/12/2013	- 845	**- 845**
Saldo sipas Llogarisë bankare të rregulluar		**12,493**